



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT PËR KRYETAR NË BASHKINË HIMARË Z. DHIONISIOS ALFRED PETRO BELERI, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 17.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar në Bashkinë Himarë në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 10, pika 1, germa "a" dhe neni 11 i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", z. Dhionisios Alfred Petro Beleri, ka depozituar në KQZ kërkesën për rregjistrim si kandidat për kryetar të bashkisë Himarë.

Gjithashtu z. Dhionisios Alfred Petro Beleri, në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit nr. 3267 prot., datë 13.05.2019, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i kandidatit për kryetar bashkie.



Nr. 516 i Vendimit Data 17.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar në Bashkinë Himarë në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave, që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për kryetar në Bashkinë Himarë, z. Dhionisios Alfred Petro Beleri, ka deklaruar si vijon:

✓ në pikën 1 të formularit të vetëdeklarimit (A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?), i është përgjigjur me "Po" duke deklaruar se:

- Me vendimin nr. 752/1999, të Gjykatës së Apelit Athinë, është dënuar për veprën penale "Bashkëpunim në mbajtje arme pa leje nga personi tretë" (për këte vepër penale nuk kam kryer burgim), parashikuar nga neni 1244/1972, 2168/1993, 1780/1988, 652/1977 Kodi Penal, dhe ndaj tij është vendosur masa e dënimit 18 muaj burg me 3 vjet kusht;

- Me vendimin nr. 509 datë 26.12.2006, të Gjykatës së Apelit Vlorë, është dënuar për veprën penale "Thirrje për urrejtje nacionale, poshtërim i Republikës edhe i simboleve të saj", parashtruar me vendim të Gjykatës së Vlorës nr. 297 datë 26.06.2014, për këtë vepër penale nuk kam kryer asnjë ditë burgim, parashikuar nga neni 266,268,25, dhe ndaj tij është vendosur masa e dënimit 3 vjet burgim.

✓ në pikën 3 të formularit të vetëdeklarimit (A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?), i është përgjigjur me "Po" duke deklaruar se është ndaluar nga:

- Prokuroria Janinë, Athinë, në vitin 1995-1996 për arsye "Bashkëpunim në mbajtje arme nga personi i tretë pa leje dhe për këtë vepër nuk kam kryer burg". Rezultati i hetimit ka qënë 18 muaj burg me 3 vjet kusht.

✓ në pikën 4 të formularit të vetëdeklarimit (A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?), i është përgjigjur me "Po" duke deklaruar se është ndaluar nga:

- Prokuroria Athinë, Janinë, në datë 24.03.1995, për 1 (një) vit.

- Prokuroria Athinë, Janinë, në datë 24.03.1996, dhe ndaj tij është vendosur paraburgim vendosur paraburgim;

- Prokuroria Kufitare, Aeroporti Athinë, në datë 13.04.1999 për arsye verifikim dokumentacioni, dhe ndaj tij është vendosur 1 (një) ditë ndalim për verifikim dokumentacioni. Lëshuar si i pafajshëm.

✓ në pikën 5 të formularit të vetdeklarimit (A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?) i është përgjigjur me "Po" duke deklaruar se:

- Gjykata e Apelit Athinë e ka akuzuar për veprën penale "Bashkëpunim në mbajtje arme pa leje nga personi i tretë, (për këtë vepër deklaroi se nuk ka kryer burgim), parashikuar nga neni 1244/1972, 2168/1993, 1780/1988, 652/1977. Vepër penale për të cilën është vendosur 18 muaj burg me 3 vjet kusht. Paraburgim nga 24.03.1995 deri më 24.03.1996 muaj të kryer në Janinë për shkak se është bërë ndalimi, pjesa tjetër në Athinë.

Ndaj tij është caktuar masë e sigurisë personale:

- Arrest në burg.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar bashkie, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore, sipas së cilës rezulton se z. Dhionisios Alfred Petro Beleri:

Në bazë të vendimit nr. 302 datë 18.07.2006 të Gjykatës së Rrethit Vlorë, është deklaruar fajtor për veprën penale "Të thirrjes së urrejtjes nacionale", "Poshtërim i Republikës dhe i simboleve të saj", të parashikuar nga nenet 266, 25, 268 i K.P dhe në bazë të këtyre dispozitave, në bashkim të dënimeve është dënuar me 3(tre) vjet burgim. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 509 datë 26.12.2006 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 302 datë 18.07.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjykata e Lartë me vendimin nr. 09 datë 04.02.2009 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 509 datë 26.12.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Në bazë të nenit 69 Kodi Penal rehabilitohet.



Nr. 516 i Vendimit Data 17.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar në Bashkinë Himarë në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave, që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Referuar gërmes "c", të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim.

Ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar/ dënuar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

.....

4. Për personat që parashikohen nga shkronja "c", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

.....

9. Ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përlogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj. Ky ligj nuk zbatohet për dënime të dhëna për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit.

Ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për personat që parashikohen nga shkronja "c", të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë. Referuar masës së dënimit dhe datës kur ka filluar ekzekutimi i dënimit, dënimi duhet të përfundojë më datë 19.07.2009.

KQZ, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 duhet të shqyrtojë nëse janë evidentuar nga procesi i verifikimit të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga neni 2 i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Veprat penale "Të thirrjes së urrejtjes nacionale", "Poshtërim i Republikës dhe i simboleve të saj", të parashikuara nga nenet 266,25, 268 i K.P e dhe koha e dënimit dënimit me 3 vjet burgim përfshihet , në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashkuar të nenit 2, pika 1, germa "c" e ligjit nr. 138/2015.

Sipas parashikimeve të pikës 13 të Vendimit të Kuvendit 17.2016, KQZ pas i konstatoi se të dhënat përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga nenin 2 i ligjit nr. 138/2015, KQZ verifikoi nëse ato përfshihen brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr.138/2015.

Në bazë nenit 4 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për personat që parashikohen nga shkronja "a", të



Nr. 516 i Vendimit Data 17.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar në Bashkinë Himar në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave, që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, z. Dhionisios Alfred Petro Beleri kandidati për Kryetar Bashkie Himarë, është brenda periudhës së ndalimit të ushtrimit të funksionit deri më datë 19.07.2019.

Referuar datës së vendimit nr. 302 datë 18.07.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, masës së dënimit me 3 (tre) vjet burgim, vërtetimit të gjendjes gjyqësore, z. Dhionisios Alfred Petro Beleri përfshihet brenda periudhës së ndalimit për kandidimin në funksionin e kandidatit për kryetar bashkie.

Për sa më sipër duke qene se kushtet për ndalim janë verifikuar para procesit të pranimit të kandidaturës, referuar nenit 10 pika 1, germa "c" të ligjit nr. 138/2015, KQZ duhet të refuzoj kandidaturën e z. Dhionisios Alfred Petro Beleri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, germa "f", nenit 10, pika 1, germa a, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI:

1. Të refuzojë kandidaturën e z. Dhionisios Alfred Petro Beleri, kandidat për Kryetar Bashkie Himarë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 516 i Vendimit Data 17.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar në Bashkinë Himarë në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave, që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"